


Anketa Tremujore e Forcave të Punës


Tremujori III 2016

Tiranë, më 12 dhjetor 2016: Në tremujorin e tretë 2016, shkalla e punësimit është 57,1 %. Punësimi gjatë këtij tremujori shfaq një tendencë në rritje si në terma vjetorë, ashtu dhe në terma tremujorë. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2015, punësimi u rrit me 8,5 %. Krahasuar me tremujorin e dytë të këtij viti punësimi u rrit me 2,9 %.


Në tremujorin e tretë 2016, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 14,7 %. Krahasuar me tremujorin e dytë 2016, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,8 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2015, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 2,5 pikë përqindje.



Në tremujorin e tretë të vitit 2016, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 67,3 %. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2015, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 2,6 pikë përqindje më e lartë.



Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës



Shkalla e punësimit




Shkalla zyrtare e papunësisë

Për femrat, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 59,2 %, ndërsa për meshkujt ky tregues është 75,3 %. Për meshkujt, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 16,1 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2015, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për femrat është rritur me 4,5 pikë përqindje, ndërsa për meshkujt me 0,9 pikë përqindje.

Shkalla e punësimit për meshkujt është 64,3 %, ndërsa për femrat 50,8 %. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2015, shkalla e punësimit për meshkujt është rritur me 2,9 pikë përqindje, ndërsa për femrat rritja është me 5,8 pikë përqindje.




Shkalla zyrtare e papunësisë për meshkujt është 15,3 % dhe për femrat është 14,0 %. Shkalla e papunësisë për femrat është 1,3 pikë përqindje më e ulët sesa për meshkujt. Krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2015, shkalla e papunësisë për meshkujt ka rënë me 1,7 pikë përqindje dhe për femrat ka rënë me 3,5 pikë përqindje.



Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2016, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 46,1 %. Shkalla e punësimit të të rinjve është 33,5 %. Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë është 27,4 %. Shkalla e papunësisë për të rinjtë ka pësuar një rënie prej 2,5 pikë përqindje,


krahasuar me tremujorin pararendës. Edhe në terma vjetorë shkalla e papunësisë së të rinjve shfaq tendencë në rënie. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2015, shkalla e papunësisë për të rinjtë në tremujorin e tretë të vitit 2016 është 4,9 pikë përqindje më e ulët.

Për popullsinë 30-64 vjeç, në tremujorin e tretë 2016, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 77,5 %, ndërsa shkalla e punësimit është 68,5 %. Shkalla e papunësisë për këtë grup-moshë është 11,7 %. Krahasuar me tremujorin pararendës për këtë grup-moshë pati një rënie të lehtë të shkallës së papunësisë me 0,2 pikë përqindje. Edhe në terma vjetorë ky tregues pësoi një rënie të lehtë me 1,2 pikë përqindje.


	Popullsia 15-29 vjeç	Popullsia 30 - 64 vjeç	Popullsia 15 - 64 vjeç
			
Shkalla zyrtare e papunësisë	27,4 %	11,7 %	15,2 %
Shkalla punësimit	33,5 %	68,5 %	57,1 %
Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës	46,1 %	77,5 %	67,3 %

Ritmi i rritjes së punësimit sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë, nga tremujori i dytë 2016 në tremujorin e tretë 2016 është: 5,1 % në sektorin e industrisë, 2,5 % në sektorin e shërbimeve dhe 2,3 % në sektorin e bujqësisë.

Në terma vjetorë, punësimi për popullsinë 15 vjeç e lart u rrit me 8,5 %. Punësimi në sektorin e industrisë u rrit me 13,6 % dhe në sektorët e shërbimeve u rrit me 8,2 %. Rritje të numrit të të punësuarve në terma vjetorë pati dhe sektori i bujqësisë me 7 %.



Shkalla zyrtare e papunësisë sipas qarqeve



Shënim metodologjik

Shkalla e punësimit: Numri i personave të punësuar në moshë 15 deri 64 vjeç pjesëtuar me popullsinë në moshë 15 deri 64 vjeç.

Shkalla zyrtare e papunësisë: Numri i personave të papunës të moshës 15 e lart pjesëtuar me numrin e personave në forcën e punës (të punësuar e të papunë) të moshës 15 vjeç e lart.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës: numri i personave në moshë 15 deri 64 vjeç në forcën e punës pjesëtuar me numrin e popullsisë në moshë 15 deri 64 vjeç.

Publikimi tjetër: **10 mars 2017**

Tabelat në format excel mund të shkarkohen në linkun:

<http://www.instat.gov.al/al/themes/tregu-i-punes.aspx>